



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Mbledhja nr. 27/2023

Prishtinë, më 03.10.2023, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Pal Lekaj dhe Duda Balje.

Mungoi: Ferat Shala.

Të ftuar: Ejup Hasolli, zyrtar kryesor financiar, ZRRE, Ymer Fejzullahu, kryesues bordi, ZRRE, Lutfiqe Dervishi, anëtare bordi, ZRRE, Gani Bucaj, anëtar bordi, ZRRE, Arta Isufi, anëtare bordi, ZRRE, Adnan Preniqi, anëtar bordi, ZRRE.

Pjesëmarrës të tjerë: Sami Gashi, GP-LVV, Egzona Tërdevci, GP-LVV, Elsa Krasniqi, GP-LVV; Jeton Bajraktari, zyrtar për analiza, Kuvend, Anduena Shtavila, asistente, GP-LDK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Elfete Alshiqi-Beqiri, Sabrije Saliuki, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur të Komisionit më datë 20.9.2023;**
- 3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2023;**
- 4. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2023;**
- 5. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2022;**
- 6. Votimi i raportit vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2022;**

7. **Votimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2022;**
8. **Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022;**
9. **Votimi në parim i Projekt-Kodit nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave;**
10. **Votimi i Projektligjit nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm;**
11. **Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2022;**
12. **Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për 6- mujorin e parë të vitit 2023;**
13. **Të ndryshme.**

1.Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika 3 dhe 4 e rendit të ditës, të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohet rendi i ditës me ndryshime(pa piken 3 dhe 4).

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur të Komisionit më datë 20.9.2023;

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohet procesverbali i Komisionit, i datës 20.9.2023.

3.Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2022

Kryetari njoftoi se Komisioni, në cilësinë e Komisionit funksional, më datë 10 , 17 maj dhe 26 korrik 2023, ka shqyrtuar raportin vjetor të OSHP-së. Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 20.9.2023, ka vendosur që rekomandimet t'i propozojë në mbledhjen e radhës.

Kryetari, pasi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës të mos miratojë raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2022.

4.Votimi i raportit vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2022

Kryetari njoftoi se për këtë pikë, diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 26 korrik 2023, andaj sot e vendosi raportin në votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2022, me rekomandimet si vijon:

1. KPM të bëjë trajtimin e lëndëve për inkasimin e borxheve;
2. KPM të bëjë planifikimin për digjitalizimin e pajisjeve.

5.Votimi i Raportit vjetor Financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2022

Kryetari njoftoi se për këtë pikë, diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 26 korrik 2023, andaj sot e vendosi raportin në votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Raport

Miratohet raporti vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2022, me rekomandimet si vijon:

1. ARKEP t'i inkasojë borxhet e akumuluar;
2. ARKEP të realizojë planifikimet e buxhetit sipas planit të veprimit;
3. ARKEP të bëjë matjen e cilësisë së internetit dhe qasjes në të, në zonat e pambuluara me internet; edhe përkundër pagesës për qasje.

6.Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022

Kryetari njoftoi se për këtë pikë diskutimet kanë mbaruar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 20.9.2023, andaj sot e vendosi në votim raportin.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022.

7. Votimi në parim i Projekt-Kodit nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave

Kryetari njoftoi se për këtë pikë diskutimet kanë mbaruar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 20.9.2023, andaj sot e vendosi projektligjin në votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projekt-Kodi nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave.

8. Votimi i Projektligjit nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm

Kryetari njoftoi se për këtë pikë, diskutimet kanë mbaruar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 20.9.2023, andaj sot e vendosi projektligjin në votim.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2022

Kryetari: Në bazë të nenit 98, paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit, Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton raportin vjetor të organit të pavarur dhe i paraqet raport me rekomandime Kuvendit, pasi që raporti financiar dhe i auditimit të atij organi të jetë shqyrtuar nga komisionet përkatëse dhe t'i jenë proceduar Komisionit funksional. Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 05/L-184 për Rregullatorin e Energjisë, kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës, çdo vit, raportin vjetor, jo më vonë se tre muaj pas mbylljes së vitit kalendarik. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka dërguar raportin vjetor në Kuvend dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë raportin financiar të ZRRE-së. Lidhur me këtë pikë kemi ftuar përfaqësuesit e ZRRE-së, nga të cilët kërkojmë që të prezantojnë dhe arsyetojnë raportin në fjalë e pastaj do të hapim diskutimet për anëtarët e Komisionit.

Ymer Fejzullahu: Raporti vjetor financiar i ZRRE-së për vitin 2022 është i përpiluar sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Rregullatorin për Energji dhe në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Të hyrat për ZRRE-në për vitin 2022 kanë qenë 1,174,798 euro, ndërsa shpenzimet kanë qenë 708,181 euro. Diferenca e këtyre dyjave janë derdhur në Buxhetin e Kosovës. Realizimi i buxhetit për ZRRE-në për vitin 2022, është si në vijim: Paga dhe mëditje janë shpenzuar 439,869 euro apo 92.5%, mallra dhe shërbime janë shpenzuar 180,000 euro apo 97.45%, shpenzime komunale kanë qenë 17,000 euro apo 77.62%, shpenzime kapitale janë shpenzuar 70,000 euro apo 99.23%. Në total, të gjitha kategoritë e shpenzimeve, buxheti i realizuar nga ana e ZRRE-së është 93.97% .

Eman Rrahmani: Po e shoh raportin e auditorit, që është i kualifikuar dhe kisha dashur një shpjegim.

Ymer Fejzullahu: Gjatë vitit 2022 kemi pasur për auditim auditorin e Përgjithshëm dhe nga ai raport kanë rezultuar tri gjetje. Njëra nga to është rreth mosinkasimit nga ana e ZRRE-së të mjeteve nga ana e Termokos-it për 4 vite: 2009, 2010, 2011 dhe 2012. Në bazë të rekomandimeve të

auditorit, ZRRE-ja i ka mbledhur ato mjete dhe është diku vlera prej 19,000 euro. Gjetja tjetër nga ana e auditorit ka qenë edhe mosregjistrimi i pasurisë. Edhe ky rekomandim është përbushur. Gjetja e tretë ka qenë sa i përket e-pasurisë. Ne i kemi bërë kërkesë ministrisë gjegjëse që ta instalojë programin, mirëpo deri më tani ai sistem nuk është instaluar. Nga tri rekomandimet e auditorit, dy janë plotësuar, ndërsa një jo.

Jeta Statovci: Një prej shpenzimeve më të mëdha vazhdon të mbetet qiraja, ku krahasuar me vitin e kaluar, është dyfishuar. Një shpenzim tjetër i cili nuk i ka informatat e nevojshme e që është blerje deri në 70,000 euro për pajisje të teknologjisë informative. Kërkoj sqarime më të detajuara për këto dy kategori të shpenzimeve.

Ymer Fejzullahu: Ne jemi shpërngulur në një objekt privat. Për atë zonë ku jemi dhe ofertat që i kemi pranuar, asnjë prej institucioneve nuk e kanë më lirë se ne. Ministria e Bujqësisë është përballë nesh dhe e ka dyfishin.

Jeta Statovci: Ajo është kontratë e trashëguar. Ju nuk keni nevojë të jeni në qendër, të hyrat kanë shkuar në rënie.

Ymer Fejzullahu: Kemi pasur dy oferta të hapura dhe është zgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme. Para një viti ka qenë kjo, ndërsa për sa i përket pajisjeve të IT-së janë shpenzime që kanë të bëjnë me serverët.

Ejup Hasolli: Është fjala për serverët, një pjesë janë licencuar nga “MICROSOFT” mbi një vit përdorimi. Pothuajse çdo vit, një shumë të përafërt e kemi shpenzuar për pajisje teknologjike.

Jeta Statovci: Nëse po thoni që është shpenzim që bëhet çdo vit, në vitin 2020 ka qenë 34 mijë e tash ka dyfishim.

Ejup Hasolli: Në vitin 2020, buxheti është shkurtuar nga qeveria, jo që nuk kemi pasur nevojë. Vetëm një server ka kushtuar 40 mijë euro.

Ymer Fejzullahu: Në atë server i kemi pothuajse 90% të të dhënave të gjithë sektorit. Të gjitha programet janë të përfunduara, por në mungesë të serverit nuk kanë mundur të publikohen. Open data është publikuar, azhurnimi i të dhënave bëhet çdo vit për gjithë sektorin. Në rast se e hapim tregun sipas direktivës, konsumatorit duhet t’i bëhet e mundur krahasimi i çmimeve, në mënyrë që të zgjedhin furnizuesin. Platforma është në fazën finale dhe pritet një shpenzim shtesë prej 20 mijë eurosh. Ka mbetur vetëm aspekti teknik që pritet të përfundohet këtë vit.

Pal Lekaj: Ajo që është shqetësuese janë rekomandimet. Të keni një opinion të kualifikuar ndikon mjaft në punën tuaj, si institucion. Deri tani nuk kemi pasur raste që të vijë një opinion i kualifikuar për çështje të tilla. Por, do ta shohim se a do të ketë opinione të tilla për çështje të ngjashme tek organizatat e tjera. Në të gjeturat e tjera, e kemi regjistrimin e pasurisë. Kush e ka përgjegjësinë për këtë, a është marrë ndonjë ndëshkim ndaj personit përgjegjës, a keni marrë vendim t’i përmirësoni këto gabime? Pse ZRRE nuk e përdor sistemin E-Kosova? A ka zyrtar kompetent që merret me

këtë punë apo keni mungesë? Pse nuk keni ndërmarrë veprime ndaj operatorit që ka borxh 93 mijë euro, a ka lidhje të kryesuesit apo të zyrtarëve të tjerë me këtë operator?

Ymer Fejzullahu: E kemi pasur personin e trajnuar. Pas vjedhjes që është bërë në ministri, është kërkuar ndërrimi i 'passwordit', por kjo nuk është lejuar pa certifikatën e trajnimit, të cilën nuk e kanë pasur as personi, as ministria. Pas një kohe të shkurtër, pasi është kryer auditimi, është bërë regjistrimi i pasurisë nga personi. Sa i përket E-Kosova, me sa kam informata edhe organizatat e tjera e kanë të njëjtin problem, pasi ministria nuk po arrin ta finalizojë. Për sa i përket borxhit që e ka Termokosi, janë borxhe të viteve 2009-2012, të cilat janë inkasuar pas gjetjes së auditorit.

Mërgim Lushtaku: Pjesa e shpenzimeve nuk është dashur të ndodh. ZRRE nuk është institucion që ka punë me palë çdo ditë, që ta ketë objektin në qendër. Te pjesa e të hyrave jotatimore, shihet që keni dështuar dhe keni më pak nga sa keni planifikuar dhe në krahasim me vitet e kaluara janë më pak.

Ymer Fejzullahu: Ne kemi kontakte të përhershme me konsumatorë, nuk ka ditë të vetme që nuk kemi punë me palë. Ligji i ZRRE-së thotë që zyra nuk duhet të jetë më larg se 1 km nga Kuvendi i Kosovës.

Mërgim Lushtaku: A keni bërë kërkesë tek institucionet publike për gjetje të hapësirës?

Ymer Fejzullahu: Po, kemi kërkuar të vendosemi në objekte publike. Ne, sipas ligjit, i kemi të hyrat e dedikuara. Kostot për objektin tonë nuk i kalojnë 500 mijë euro. Kemi kërkuar nga ministria që të na mundësoj, ta fillojmë objektin tonë, por nuk jemi prioritet i ministrisë. Shumicën e rasteve nuk marrim as përgjigje nga ministria, përveç përgjigjeve, nuk jeni prioritet.

Mërgim Lushtaku: Tek të hyrat jotatimore janë 465 mijë më pak se planifikimi.

Ejup Hasolli: 1 milion e 600 mijë euro ka qenë projeksioni nga Departamenti Makroekonomik i Ministrisë së Financave, nuk e kanë kërkuar mendimin tonë. Është zbritur taksa nga 20 centë në 15 centë, me vendim të bordit, me qëllim që të mos ngarkohet konsumatori, meqë ZRRE nuk e ka obligim të sigurojë të hyra për buxhetin e Kosovës, në bazë të ligjit.

Ymer Fejzullahu: Është edhe vendim i Gjykatës Kushtetuese, ku konstatohet që mënyra sesi shkurtohet buxheti i ZRRE-së, është ndërhyrje në rregullator. Vetëm në vitin 2017, nuk është shkurtuar në qeveri, në të gjitha rastet është bërë në ministri.

Jeta Statovci: E përkrah çdo shpenzim që e rrit efikasitetin e punës, por jo ato që nuk prodhojnë asgjë. ARKEP, ARRU janë organizata që janë këtu afër dhe i kanë qiratë më të ulëta se ju. Duhet të merrni parasysh këtë në vendimet tuaja.

Ymer Fejzullahu: Ne nuk kemi dalë aty për komoditet, kemi dalë për shkak të nevojës. Në objektin e vjetër kemi pasur rrjedhje të ujit te serveri, ku janë të gjitha të dhënat, plus ka qenë ndërtime pa leje. E kemi një sallë që çdo draft-ligj dhe rregullore është e obliguar t'i konsultojë me

palët. Nuk e kemi zgjedhur ne, ka qenë proces i hapur. Hapësira është minimale për nevojat e ZRRE-së.

Mërgim Lushtaku: Pjesa e veriut, ku KOSTT e ka marrë përgjegjësinë për pagesat, ku qëndron ZRRE në këtë mes?

Ymer Fejzullahu: Tepriçat e KEK-ut kanë shkuar për veriun. Jemi në Gjykatën Kushtetuese, në tri nivele, më herët e kemi humbur rastin. Një pjesë është duke u mbuluar nga rezervat sekondare që ofrohet nga Shqipëria. ZRRE i ka përmbushur detyrat që i ka pasur në marrëveshje dhe ia ka dhënë licencën.

Mërgim Lushtaku: Vlera në vitin 2021 ka shkuar në 75 milionë euro, është rritje shumë e madhe në krahasim me vitet e kaluara. Një përgjegjësi e ka edhe ZRRE, edhe KOSTT. A keni bërë hulumtim për këtë?

Ymer Fejzullahu: Si sasi, deri më 2010, kanë shfrytëzuar 200 giga, tash i kemi 470. Trendi më i madh i rritjes ka qenë vitet e fundit. Në vitin 2020 jemi bërë zonë rregulluese, kanë filluar ta shfrytëzojnë energjinë maksimalisht. Numrat i kemi të saktë.

Kryetari: I vetmi vit kur ka rënë konsumi në atë pjesë është viti 2022, sepse gjithmonë trendi ka qenë në rritje. Të hyrat e arkëtueshme, vendimmarrja për gjambat ka qenë në vitin 2022. Pse nuk ka hyrë në vitin 2022?

Ymer Fejzullahu: Është ndarë pagesa në dy vite për KESCO-n.

Kryetari: Gjambat kur i keni shënuar këtu, keni shënuar që kanë tregtuar me kompani të palicencuara. Në bazë të Ligjit për energji, neni 32, thotë se licencat në Komunitetin e Energjisë duhet të njihen në Kosovë. Si ka mundësi që i keni dënuar? Një justifikim për këtë na dërgoni të elaboruar me shkrim. Një pyetje tjetër, a janë pastaj ato të hyra të arkëtueshme?

Ejup Hasolli: I kanë paguar.

Ymer Fejzullahu: KOSTT ka fituar rastin në shkallën e parë, ne e kemi çuar në shkallën e dytë. 100 % i kemi të fituara, i vetmi rast që nuk e kemi fituar është me Veriun. Jemi të bindur që edhe rastin me KOSTT-in do ta fitojmë.

Kryetari: KOSTT, me të gjitha kompanitë që ju thoni se janë pa licencë, të gjitha kontratat janë të nënshkruara në vitin 2016. Pse nuk është zbatuar në mënyrë konsistente kjo rregull, por vetëm tash?

Ymer Fejzullahu: Ky nen është në të gjitha vendet e Komunitetit të Energjisë, duhet një marrëveshje specifike, e cila nuk është votuar në Këshillin e Ministrave. Tash kemi memorandum me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Viti i prerjes është viti 2020. KOSTT-i ka kërkuar që të gjitha valët tregtare duhet të vijnë dhe të regjistrohen në KOSTT. Ju ka shkuar njoftimi të gjithë të licencuarve. Përveç KEK-ut, me të cilin jemi në gjykatë, të tjerët e kanë pranuar.

Kryetari: Duhet ta kemi me shkrim edhe këtë.

Gani Buqaj: Certifikata e biznesit duhet të regjistrohet në ARBK, është dispozita ligjore.

Kryetari: Në njoftimet publike të vendosen datat kur janë marrë vendimet. Detyrë e rregullatorit është që të ketë sa më shumë konkurrentë. Bosnja dhe Kroacia thonë që për shkak të krizës energjetike i kanë tërhequr licencat e kompanive, sepse kanë manipuluar me rezervat dhe iu kanë ikur obligimeve të tregut, madje edhe Serbia i ka vendosur nën monitorim. A keni pasur ju?

Ymer Fejzullahu: Përveç këtyre, është edhe një tjetër nga Maqedonia. Ne kemi edhe një prej të licencuarve tanë, që ka filluar procedurat për tërheqje nga procedurat e licencimit.

Kryetari: Krejt firmat private, emrat iu ndryshojnë, por pronarët janë të njëjtët. Po më intereson si shqetësim, sepse kjo mund të ketë pasoja në zhvillimin e tregut. Të gjitha janë në pronësi të 3 serbëve. Duhet të shohim legjislacionin, që të shohim pronarin fundor. Në 16 nëntor, thoni rregulla për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, neni 6 i të cilës ka kriteret e autorizimit. Një prej kompanive është “Energy Development LSE”, e cila kur e shohim origjinën është në pronësi të Vlera Devollit, e regjistruar në Maltë.

Ymer Fejzullahu: Çertifikatën e regjistrimit të biznesit, e kemi pasur të njëjtën me “Elektroservirin”. Në momentin që regjistrohet, ZRRE është e obliguar t’ia lëshojë licencën, sepse nuk mund të kontestojmë një vendim të një institucioni tjetër.

Kryetari: Keni bërë një hulumtim të tregut. A keni paraparë ndonjë intervenim në legjislacion për të shmangur dylicencimin?

Ymer Fejzullahu: Fatkeqësisht, jo.

Kryetari: konstatoi se në mungesë të kuorumit, vendimmarrja për këtë pikë shtyhet për mbledhjen e radhës.

10. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për 6- mujorin e parë të vitit 2023

Kryetari konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës, shtyhet për mbledhjen e radhës.

11. Të ndryshme

Për pikën të ndryshme, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit